

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	PD 146 pyetje Begajt dhe Ramës pas arrestit të Hysenit: Çfarë kriteresh dhe verifikimesh u ndoqën për e mërimin e saj në krye të SHISH? (KËRKESAT) - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/pd-146-pyetje-begajt-dhe-rames-pas-arrestit-tw-hysenit-cfare-kriteresh-dhe-verifikimesh-u-ndoqen-per-emerimin-e-saj-nw-krye-te-shish?r=kh1
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 12:34:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 12:29:33 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fda2645b3ae1c39b198786d8b6581fd93e86b76f6718a7c0737b702451b288e5
TEKSTI	e4d1145a18abe6e81d52fd0902a73b7bcaff10fa85acb52d1dd1e7dc818b8d08
PAMJA	c42f5a0dc855f2e2ba514ac0a302ce21ac3d60d31d7a0042e8c5b6bec19d3352

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	80dddb5a82621abae91aa00ddff3cb489546d4026d3612e5e6b003623da92c73
E MËPARSHMJA	5562edda97d7c54f164fc01db08c49762972d77674badd5fa02a677272a7378a
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/80dddb5a82621abae91aa00ddff3cb489546d4026d3612e5e6b003623da92c73>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



'Krimet e tij nuk duhet të glorifikohen', Grupi i Partive Popullore Evropiane dënon nderimet për Ratko Mladić në Beograd



Politikë

PD 146 pyetje Begajt dhe Ramës pas arrestit të Hysenit: Çfarë kriteresh dhe verifikimesh u ndoqën për emërimin e saj në krye të SHISH? (KËRKESAT)

Partia Demokratike i kërkon zyrtarisht Kryeministrit Edi Rama dhe Presidentit Bajram Begaj të tregojnë kriteret dhe procedurat që u ndoqën për propozimin dhe dekretimin e Vlora Hysenit në krye të Shërbimit Informativ të Shtetit.

■ Arresti i ish-kreut të SHISH, PS: S'jemi avokatë të askujt! Opozita i sulmon prokurorët me 'libër shtëpie'



Edi Rama dhe Bajram Begaj



Redaksia

29 Shtator, 14:27 | Përditësimi: 29 Shtator, 15:04

Share Tweet



Plot 146 pyetje i ka drejtuar Partia Demokratike, kreut të Shtetit [Bajram Begaj](#) dhe shefit të qeverisë [Edi Rama](#) ku kërkojnë përgjigje lidhur me kriteret dhe procedurat që u ndoqën për propozimin dhe emërimin e Vlora Hysenit në krye të Shërbimit Informativ të Shtetit në 2023-shin. Kërkesa nga deputeti demokrat Klevis Balliu, vjen pas arrestit të Hysenit nën dyshimet se ndihmoi me informacione sekrete Ergys Agasin gjatë arratisë.



"Sipas të dhënave dhe fakteve që janë bërë publike, institucione të rëndësishme të sigurisë kanë qenë nën ndikimin e Ergys Agasit. Policia e Shtetit, ku në krye të saj ndodhet Ilir Proda; AKSHI, ku drejtoreshë ka qenë Mirlinda Karçanaj; strukturat e sigurisë kibernetike ku bashkëshorti i drejtoreshës Ervina Gjana ishte shoqëruar me Agasit; si dhe SHISH, ku janë bërë publike fajet se shefja e shërbimit informativ ishte në shërbim të Agasit dhe bandave që ai koordinonte në interes të qeverisë. Nëse drejtues të institucioneve kyçe të sigurisë kombëtare i përgjigjen një personi që nuk mban asnjë funksion shtetëror, pyetja themelore është: kush e ka fuqinë dhe autoritetin për të vendosur mbi këto institucione?", deklaroi Balliu.

Në 78 pyetjet drejtuar Ramës, opozita kërkon informacion për të gjithë procesin që çoi Vlora Hysenin në krye të SHISH, që nga identifikimi dhe propozimi i kandidatës, kriteret e përzgjedhjes dhe verifikimet e kryera para emërimit, deri te informacionet që Kryeministri mund të ketë marrë gjatë kohës që ajo drejtonte shërbimin sekret. PD pyet Ramën nëse përpara emërimit ishte evidentuar ndonjë kontakt apo marrëdhënie e Hysenit me Ergys Agasin dhe nëse, gjatë drejtimit të SHISH, Kryeministri kishte dijeni për takime, telefonata apo komunikime mes tyre.





LEXO EDHE:

Ish-kreu i SHISH ankim në Apelin e Posaçëm, kërkon heqjen e arrestit në shtëpi

Ndërkohë, presidentit Begaj i janë drejtuar 68 pyetje lidhur me marrjen dhe shqyrtimin e propozimit për emërimin e Hysenit në krye të SHISH, Lidhur me informacionet e administruara nga Republika e Kosovës pas shkarkimit Agjencia Kombëtare e Inteligjencës.

Pyetjet e plota drejtuar Kryeministrit Edi Rama

I. Lidhur me procedurën e identifikimit dhe propozimit

1. Kur është identifikuar për herë të parë shtetasja [Vlora Hyseni](#) si kandidate për detyrën e Drejtorit të SHISH?
2. Nga kush është propozuar fillimisht kandidatura e saj pranë Kryeministrit, qoftë në pozicionin e këshilltares për sigurinë kombëtare, ashtu edhe të Drejtorit të SHISH?
3. A ka ekzistuar një procedurë formale për identifikimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidatëve?
4. Sa kandidatura janë shqyrtuar dhe cilat kanë qenë kriteret e përdorura për vlerësimin e tyre?
5. A ekziston një dosje administrative e procesit të përzgjedhjes së kandidaturave?
6. A është hartuar ndonjë relacion, raport, analizë, memorie, opinion juridik ose vlerësim tjetër përpara propozimit të saj?
7. Kur është përgatitur propozimi zyrtar i Kryeministrit drejtuar Presidentit të Republikës?
8. Cili ka qenë motivacioni i plotë i propozimit?
9. A është mbështetur propozimi në dokumentacion zyrtar të institucioneve shqiptare dhe të huaja apo vetëm në vlerësimin personal të Kryeministrit?
10. Në vijim të deklarimit tuaj se kandidatura e shtetasës Hyseni është mbështetur edhe në referenca të shërbimeve partnere:
 - (i) Cilat shërbime kanë dhënë këto referenca?
 - (ii) Kur janë marrë këto referenca?
 - (iii) Në çfare forme?
 - (iv) Kush i ka vlerësuar?
11. A janë kërkuar posaçërisht referenca për shtetasen Hyseni nga shërbimet partnere përpara propozimit?
12. A është kërkuar informacion nga shërbimet e inteligjencës dhe sigurisë të vendeve aleate dhe partnere?
13. A është kërkuar informacion nga autoritetet e Republikës së Kosovës lidhur me veprimtaritë e mëparshme të shtetasës Hyseni?
14. Cilat institucione të Republikës së Kosovës janë kontaktuar?
15. A keni kërkuar informacion nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI) lidhur me periudhën e ushtrimit të detyrës së zëvendës drejtorit nga shtetasja Hyseni?
16. A është kërkuar informacion mbi rrethanat e largimit të saj nga detyra në institucionet e sigurisë së Kosovës?
17. A është kërkuar informacion mbi ndonjë verifikim sigurie, procedim administrativ, disiplinor, penal apo hetim të mëparshëm ndaj saj?
18. Nëse është marrë informacion nga autoritetet e Kosovës, kur është marrë dhe cili ka qenë konkluzioni i tij?

II. Lidhur me verifikimet e kryera përpara emërimit

19. Cilat institucione shqiptare kanë kryer verifikimin e kandidaturës së shtetasës Hyseni?
20. Kur ka filluar dhe ka përfunduar ky verifikim?
21. A është kryer një verifikim i posaçëm i sigurisë dhe integritetit?

22. Cilat institucione shqiptare jane kontaktuar?
23. A janë konsultuar SHISH, SHIU, Policia e Shtetit, SPAK, Prokuroria e Përgjithshme, AMP, AKSIK ose institucione të tjera ligjzbatuese?
24. A është kërkuar informacion nga SPAK përpara propozimit të saj?
25. Nëse po, në çfarë date dhe çfarë informacioni është marrë?
26. A ka pasur, në momentin e propozimit, ndonjë hetim, procedim, verifikim ose material të administruar nga SPAK ku shtetasja Hyseni përmendej direkt apo indirekt?
27. A është kontrolluar ekzistenca e kallëzimeve, referimeve apo materialeve të tjera hetimore lidhur me të?
28. A është kryer ndonjë verifikim mbi kontaktet e saj me persona të përfshirë në hetime apo procedime penale?
29. Nga verifikimet e kryera, a ka rezultuar ndonjë kontakt apo marrëdhënie personale, profesionale, financiare apo të ndonjë natyre tjetër me shtetasin Ergys Agasi?
30. Nëse po, çfarë informacioni është administruar dhe cili ka qenë konkluzioni i tij?
31. A është kryer ndonjë vlerësim për konflikt të mundshëm interesi në ushtrimin e detyrës nga shtetasja Hyseni?
32. A është hartuar një vlerësim formal mbi besueshmërinë dhe integritetin e kandidaturës së saj?
33. Nëse po, cilat kanë qenë përfundimet e këtij vlerësimi?

III. Lidhur me informacionet e administruara nga partnerët ndërkombëtarë

34. A ka kërkuar Kryeministria informacion nga partnerët ndërkombëtarë për shtetasen Vlora Hyseni?
35. A është kërkuar informacion nga strukturat përkatëse të NATO-s?
36. A është marrë ndonjë informacion nga shërbimet partnere lidhur me besueshmërinë e saj?
37. A kanë pasur partnerët ndonjë rezervë apo paralajmërim?
38. A kanë komunikuar partnerët ndonjë shqetësim lidhur me kontakte, marrëdhënie apo veprimtari të shtetasës Hyseni?
39. A ka pasur ndonjë informacion të klasifikuar nga partnerët që ka qenë në dispozicion të Kryeministrit përpara emërimit?
40. Nëse po, kërkohet të identifikohet dokumenti, data, institucon dërgues dhe niveli i klasifikimit në masën e lejuar nga ligji.

IV. Lidhur me informacionet e administruara gjatë ushtrimit të detyrës

41. Gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës nga shtetasja Hyseni, a ka marrë Kryeministri informacion nga SHISH, SPAK, Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, partnerët ndërkombëtarë ose institucione të tjera lidhur me veprimtarinë e saj?
42. A është informuar Kryeministri për ndonjë dyshim mbi respektimin e rregullave të informacionit të klasifikuar?
43. A është informuar për ndonjë incident të sigurisë së informacionit?
44. A është informuar për ndonjë kontakt të papërshtatshëm të saj me persona jashtë strukturave të autorizuara?
45. A është informuar ndonjëherë për kontakte me shtetasin Ergys Agasi?
46. Nëse po, kur është marrë për herë të parë ky informacion dhe nga cili institucion?
47. A është kryer ndonjë verifikim pas marrjes së këtij informacioni?
48. A është informuar apo ka pasur dijeni Kryeministri për ekzistencën e një dokumenti të përgatitur nga një punonjës i SHISH lidhur me implikimin e shtetasës Vlora Hyseni në procedurat e prokurimit publik të AKSHI?
49. A është informuar Kryeministri se shtetasja Hyseni mund të ishte subjekt i një hetimi penal?

50. Nëse po, kur është informuar dhe nga cili autoritet?
51. A e ka informuar vetë shtetasja Hyseni Kryeministrin se ishte subjekt i ndonjë hetimi, verifikimi apo procedure?
52. A e ka informuar shtetasja Hyseni Kryeministrin se ishte marrë në pyetje nga hetuesit e BKH-së?
53. Nëse po, kur dhe në çfarë rrethanash?
54. A ka kërkuar Kryeministri ndonjë raport apo verifikim të posaçëm nga SHISH lidhur me këto çështje?

V. Lidhur me kontaktet me shtetasin Ergys Agasi

55. A ka pasur Kryeministri dijeni, përpara zhvillimeve të fundit, për ekzistencën e kontakteve të shtetasës Vlora Hyseni dhe shtetasit Ergys Agasi?
56. A ka qenë Kryeministri në dijeni për takime të tyre?
57. A ka qenë në dijeni për komunikime telefonike, elektronike ose të tjera?
58. A ka qenë në dijeni për ndonjë komunikim që lidhej me çështje institucionale, qeveritare, të drejtësisë, policisë ose sigurisë?
59. A ka diskutuar ndonjëherë shtetasja Hyseni me Kryeministrin lidhur me shtetasin Ergys Agasi?
60. A ka kërkuar ndonjëherë ndërhyrjen ose ndihmën e Kryeministrit për çështje që lidheshin me të?
61. A ka kërkuar Kryeministri nga ndonjë institucion informacion mbi natyrën e marrëdhënieve të shtetasve Hyseni-Agasi?

VI. Lidhur me informacionet e nga NATO dhe partnerët ndërkombëtarë gjatë detyrës

62. A ka marrë Kryeministria gjatë periudhës Prill 2023 – Shtator 2026 raporte apo komunikime nga NATO lidhur me shtetasen Vlora Hyseni?
63. A ka marrë informacion mbi sigurinë e informacionit të klasifikuar në SHISH?
64. A ka marrë informacion nga partnerët mbi ndonjë risk të mundshëm që lidhej me shtetasen Hyseni?
65. A ka pasur ndonjë rezervë nga partnerët lidhur me aksesin e saj në informacion të klasifikuar?
66. A kanë kërkuar partnerët ndonjë masë korrigjuese apo verifikim shtesë?

VII. Lidhur me shkarkimin nga detyra e Drejtorit të SHISH

67. Kur ka marrë Kryeministri informacionin e parë lidhur me masat e sigurisë ndaj shtetasës Hyseni?
68. Cili ka qenë Kur ka vendosur të propozojë shkarkimin e saj?
69. motivacioni i plotë i shkarkimit nga detyra?
70. A është bazuar propozimi për shkarkim vetëm në masat e sigurisë apo edhe në informacione të tjera?
71. Nëse po, cilat institucione i kanë këto informacione në dispozicion?
72. A është konsultuar Presidenti i Republikës përpara propozimit?
73. A është kërkuar ndonjë raport nga ana e SHISH?
74. A është bërë ndonjë vlerësim mbi dëmin e mundshëm ndaj sigurisë kombëtare?
75. A është bërë ndonjë vlerësim mbi informacionin e klasifikuar që mund të jetë ekspozuar apo kompromentuar?
76. A janë informuar paraprakisht NATO dhe partnerët ndërkombëtarë?

77. A janë marrë masa konkrete për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar pas largimit të shtetases Vlora Hyseni nga detyra?

78. Nëse po, cilat janë këto masa dhe kur janë marrë ato?

Lajmi në përditësim.....


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. _____ Prot. _____ Tiranë, më _____, 2026

Lënda: Kërkesë për informacion.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.